



RAPORT I MONITORIMIT TË PËRPUTHSHMËRISË

Investimi i IFC në enso Shqipëri Project #30979

Ankesa 01

**Raporti i Monitorimit të Përgjigjes së IFCsë ndaj:
Hetimit të CAO të Investimit të IFC në enso Shqipëri
(Hidrocentrali i Lengaricës)**

Dhjetor 3, 2019
Zyra e Avokatit të Popullit Këshilltar për Pajtueshmërinë (CAO)

Rreth CAO

Misioni i CAO është të shërbejë si një mekanizëm ankimor i pavarur, i drejtë, i besuar, dhe efektiv dhe për të përmirësuar përgjegjshmërinë mjedisore dhe sociale të IFC dhe MIGA.

CAO (Zyra e Avokatit të Popullit Këshilltar për Pajtueshmërinë) është një post i pavarur që i raporton drejtpërdrejt Presidentit të Grupit të Bankës Botërore. CAO shqyrton ankesat nga komunitetet e prekura nga projektet e zhvillimit të ndërmarra nga të dy krahët e sektorit privat të Grupit të Bankës Botërore, Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Agjencia për Garantimin e Investimeve Shumëpalëshe (MIGA).

Për më shumë informacion në lidhje me CAO, ju lutemi vizitoni www.cao-ombudsman.org

Hyrje dhe Histori

Funksioni i përputhshmërisë i CAO kryen hetime të performancës mjedisore dhe sociale (M&S) të IFC/MIGA për të vlerësuar përputhshmërinë me kërkesat përkatëse dhe për të përmirësuar performancën institucionale M&S. Pas një hetimi të përputhshmërisë nga CAO, CAO monitoron veprimet e ndërmarra nga IFC/MIGA deri sa këto veprime të tregojnë që janë trajtuar përfundimet e arritura nga hetimi.

Ky raport monitorimi i përputhshmërisë lidhet me hetimin e CAO i investimit të IFC në enso Shqipëri (“hetimi i përputhshmërisë”).¹ Procesi i vlerësimit të përputhshmërisë i CAO u vu në lëvizje nga një ankesë e marrë në Qershor 2015 nga banorët vendas dhe ambientalistët në lidhje me ndikimet M&S të hidrocentralit të Lengaricës (“HEC Lengarica” ose “projekti”) në jug të Shqipërisë, i ndërtuar nga klienti i IFC, enso Shqipëri. Ankuesi pretenduan që projekti ka pasur ndikimet mbi speciet e rrezikuara dhe habitatet natyrore/kritike. Ata pretendojnë që ka ndikime mbi shërbimet e ekosistemit, në veçanti mbi vlerën ekoturistike e lumit të Lengaricës dhe të zonave të mbrojtura dhe monumenteve të natyrës afër tij. Ata gjithashtu ngrenë pretendime që HEC Lengarica nuk ka qenë në përputhje me kërkesat e IFC për publikimi i informacionit, konsultimin dhe angazhimin e palëve të interesuara.

CAO ka nxjerrë një hetim të përputhshmërisë në përgjigje të ankesës në Tetor 2018. Hetimi arriti në disa përfundime mos-përputhshmërie në lidhje me vlerësimin paraprak dhe mbikëqyrjen e projektit nga IFC.²

Në veçanti, raporti i hetimit arriti në përfundimin që ka çështje të pazgjidhura që duhet të adresohen nga IFC dhe klienti i saj në lidhje me:

- (a) Publikimin M&S dhe informacionin e monitorimit për HEC Lengarica.
- (b) përafrimin e HEC Lengarica me planin e menaxhimit për Parkun Kombëtar Bredhi i Hotovës-Dangëlli, brenda të cilit ai ndodhet; dhe
- (c) vlerësimin dhe zbutjen e ndikimeve të projektit mbi turizmin.

Një përgjigje e drejtuesve të IFC u nxor së bashku me raportin e hetimit.³ Përgjigja e IFC parashikonte një numër veprimesh për të trajtuar përfundimet e hetimit në nivel projekti, dhe vuri në dukje përmirësimet e bëra në nivel politikash, procedurash, praktikash dhe njohurish.

Ky raport i parë monitorimi dokumenton përgjigjen e IFC ndaj hetimit të përputhshmërisë në periudhën Tetor 2018 - Nëntor 2019.

Vërejtje nga Monitorimi i CAO (Tetor 2018 - Nëntor 2019)

Ky seksion përmbledh përditësimet e IFC për CAO rreth veprimeve të ndërmarra për të trajtuar përfundimet e hetimit në nivel projekti që nga nxjerrja e raportit të hetimit të përputhshmërisë në Tetor 2018. Ai gjithashtu përmbledh këndvështrimet e ankuesve në lidhje me angazhimin e IFC për të trajtuar këto përfundime.

Veprime në nivel projekti

IFC i raportoi CAO hapat që po merren për të trajtuar përfundimet e hetimit në nivel projekti në lidhje me:

- **Angazhimin e palëve të interesuara dhe shpërndarjen e informacionit.**

¹ Hetimi i CAO, përgjigja e IFC ndaj hetimit dhe materialet përkatëse janë të disponueshme në faqen e internetit të CAO. Shiko <https://bit.ly/2lUdv0>

² Raporti i Hetimit të Përputhshmërisë i CAO, enso Shqipëri -01, Tetor 2018 - <https://bit.ly/2MFGK9t>

³ Përgjigja e IFC ndaj Raportit të Hetimit të Përputhshmërisë të investimit të IFC në enso Shqipëri, Shtator 2018 – <https://bit.ly/2NI3IGB>

- **Përafrimin e HEC Lengarica me planin e menaxhimit për Parkun Kombëtar Bredhi i Hotovës-Dangëlli, dhe**
- **vlerësimin dhe zbutjen e ndikimeve të projektit mbi turizmin.**

Angazhimi i palëve të interesuara dhe shpërndarja e informacionit

Përfundimet e Hetimit të CAO

Hetimi i CAO arriti në përfundimin që zbatimi i kërkesave të IFC për publikimin e informacionit, konsultimin dhe angazhimin e palëve të interesuara për HEC Lengarica ishte i paplotë. Konsultimi i palëve të interesuara gjatë fazës së projektimit të HEC Lengarica ishte i kufizuar. Si pasojë, IFC punoi me klientin për të përgatitur një Plan të Angazhimit të Palëve të Interesuara që dokumentoi angazhimet e klientit me grupe më të gjera të palëve të Interesuara gjatë periudhës 2013 – 2015. Në kundërshtim me kërkesat e SP1 dhe politikën e IFC për publikimin e informacionit, IFC nuk siguroi publikimin e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) të klientit të muajit Qershor 2011) mbi të cilin IFC bazoi shqyrtimin e saj M&S. Publikimi i dokumentacionit të mëtejshëm të vlerësimit dhe monitorimit M&S kishte gjithashtu mangësi, si dhe informacioni në gjuhën vendase rreth rreziqeve dhe ndikimeve M&S të projektit.

Veprimet e IFC në përgjigje të Përfundimeve

Në veprimin #10 të përgjigjes së drejtuesve, IFC vuri në dukje që VNMS fillestare (2011) i Lengaricës ishte publikuar përmes Portalit të IFC mbi Informacionin e Projektit në Shtator 2018.⁴ CAO vë në dukje edhe që kompania po publikon përditësime të rregullta në faqen e saj të internetit me të dhëna monitorimi në lidhje me rrjedhën ekologjike të lumit.⁵

Përafrimi i HEC Lengarica me planin e menaxhimit për Parkun Kombëtar Bredhi i Hotovës-Dangëlli

Përfundimet e Hetimit të CAO

Hetimi arriti në përfundimin që çështja e vendndodhjes së HEC Lengarica brenda Parkut Kombëtar Bredhi i Hotovës-Dangëlli, është anashkaluar në kohën kur IFC miratoi investimin në vitin 2011. Megjithatë, pasi çështja u ngrit nga palët e interesuara në vitin 2014, IFC ndërmori hapa për tu siguruar që klienti ka marrë lejet e nevojshme për ndërtimin dhe shfrytëzimin e HEC Lengarica. Ndërkohë që ankuesit kundërshtojnë ligjshmërinë e procesit të dhënies së lejeve, hetimi vuri në dukje që këto çështje janë jashtë fushëveprimit të një shqyrtimi të përputhshmërisë nga CAO. Megjithatë, vendndodhja e HEC Lengarica brenda një Parku Kombëtar vë në lëvizje dispozitën e zonës së mbrojtur sipas SP 6, dhe CAO arriti në përfundimin që kërkohej mbikëqyrje shtesë për të siguruar që aktiviteti dhe programet e klientit janë në përputhje me planin e menaxhimit të Parkut.

Veprimet e IFC në përgjigje të Përfundimeve

Në kohën e nxjerrjes së hetimit, autoritetet shqiptare kishin përgatitur një draft plan menaxhimi për Parkun Kombëtar. Në komunikimin e saj me kompaninë si pjesë e mbikëqyrjes së projektit, IFC vuri në dukje që një aspekt i rëndësishëm i planit të veprimit M&S të klientit për vitin 2019 përfshinte pjesëmarrjen aktive në procesin e hartimit të planeve të menaxhimit për burimet termale dhe Parkun Kombëtar, me qëllim që të plotësohen angazhimet #9 dhe #11 të përgjigjes së IFC ndaj hetimit të CAO.

Në kontekstin e monitorimit të CAO, ekipi i IFC i raportoi CAO që klienti organizoi një takim me Agjencinë Kombëtare për Zonat e Mbrojtura (AKZM) për të diskutuar rolin që ata mund të luanin në zhvillimin e mëtejshëm të planit të menaxhimit të Parkut Kombëtar Bredhi i Hotovës – Dangëlli,

⁴ Përmbledhja e Shqyrtimit Mjedisor dhe Social e IFC, enso Shqipëri (projekti #30979) – <https://bit.ly/2NO225i>

⁵ Enso Hydro, informacion mbi projektin e HEC Lengarica – <https://bit.ly/2p3VE1w>

përfshirë dhe menaxhimin më të mirë të ndikimeve që lidhen me turizmin në burimet termale, dhe më gjerë në Parkun Kombëtar. Sipas IFC, ky hap i parë është një nismë pozitive, por duhet të bëhet përpunim i mëtejshëm për të arritur objektivat e planit të veprimit. IFC vuri në dukje gjithashtu që po hartohet një plan menaxhimi për Bënjën, dhe se enso Shqipëri do të konsultohet zyrtarisht në atë proces, që do të përfshinte mundësi për ditët e kajakëve që do lundrojnë përgjatë kanionit.

IFC po planifikon një vizitë mbikëqyrjeje në Shqipëri në gjysmën e parë të vitit 2020, që do të përfshinte takime me palët përkatëse të interesuara për të kuptuar më mirë rolet e mundshëm që mund të luajnë IFC dhe enso Shqipëri për të siguruar përafrimin e projektit me planin e menaxhimit të të Parkut Kombëtar.

Vlerësimi dhe zbutja e ndikimeve projektit mbi turizmin

Përfundimet e Hetimit të CAO

Hetimi arriti në përfundimin se, ndërkohë që ndikimet e HEC Lengarica mbi turizmin u vunë në dukje në shqyrtimin para-investitor të IFC, IFC nuk u sigurua që ato ishin vlerësuar dhe zbutur në përputhje me kërkesat e SP1 apo SP6 përpara ndërtimit të projektit. Mbikëqyrja pasuese nga IFC e projektit konfirmoi ndikimet mbi disa lloje të aktiviteteve të ekoturizmit, veçanërisht lundrimi me kajak në Kanionin e Lengaricës. Megjithatë, në lidhje me këto ndikim, IFC nuk kishte siguruar konsultim të mjaftueshëm me palët e interesuara apo që masat e përshtatshme për të minimizuar, zbutur dhe/ose mënjanuar ndikimet të përfshiheshin në PVMS siç kërkohet nga SP1.

Veprimet e IFC në përgjigje të Përfundimeve

Angazhimi #11 i përgjigjes së drejtuesve të IFC në lidhje me ndikimet e projektit mbi turizmin, vuri në dukje që kompania kishte filluar tashmë diskutimet me kryetarin e bashkisë Përmet rreth kësaj çështjeje, me një marrëveshje për minimumi 2 ditë fundjave në stinën me rrjedhë të ulët kur HEC Lengarica do të lëshojë ujë të mjaftueshëm nga diga poër të mundësuar që kanioni të 'përshkohet' nga lundruesit e kajakëve nga maja në fund.

Megjithatë, IFC i raportoi CAO që, megjithëse kompania është e angazhuar të përfshihet me grupet e interesuara dhe të vendosë masat zbutëse në lidhje me ndikimet e projektit mbi turizmin, kërkohet progres i mëtejshëm për të siguruar që përfundimet e hetimit po trajtohen me efektivitet. IFC deklaroi që kompania do të vazhdojë angazhimin e saj për të ndërvëpruar në mënyrë konstruktive me bashkinë për të menaxhuar më mirë ndikimet mbi turizmin.

Në diskutimet me CAO, IFC raportoi gjithashtu që po planifikon të organizojë takime me grupet përkatëse të interesuara ose drejtpërdrejt ose përmes Punonjësit të Ndërlidhjes me Komunitetin të enso Shqipëri gjatë vizitës mbikëqyrëse të radhës në zonën e HEC Lengarica, për të parë mundësitë për angazhim rreth çështjes së turizmit, dhe për të siguruar që angazhimi #6 i përgjigjes së IFC ndaj hetimit⁶ është duke u plotësuar.

Këndvështrimi i Ankuesve

Në një bisedë me CAO në Tetor 2019, ankuesit treguan që ata nuk kishin pasur kontakte me IFC apo enso Shqipëri që nga dalja e raportit të hetimit të CAO në Tetor 2018. Ata theksuan gjithashtu që ata nuk ishin të gatshëm të diskutonin me kompaninë, meqenëse që në fillim të procesit të CAO ata e shikonin kompaninë si kundërshtuese të çdo lloj negocimi. Ankuesit kërkuan që IFC të tërhiqej nga ky projekt dhe hidrocentrali të shembej për të lejuar rrjedhën normale të lumit të

⁶ Angazhimi #6 i IFC për të mbikëqyruar në mënyrë aktive projektin, përfshirë në lidhje me angazhimin e palëve të interesuara në kontekstin e ndikimeve të mundshme të projektit mbi turizmin.

Lengaricës. Ata presin që deri në mes të vitit 2020 të përfundojnë shqyrtimin e projektit me ekspertizën e tyre dhe kanë si synim t'i japin CAO një raport me shkrim.

Ankuesit treguan që shqetësimi i tyre kryesor në momentin që dorëzuan ankesën në CAO ishte mos përputhja e kompanisë me legjislacionin shqiptar. Ata vunë në dukje që politikat e IFC kërkojnë që projektet të jenë në përputhje me ligjet kombëtare, gjë që sipas mendimit të tyre nuk është rasti i HEC Lengarica, meqenëse ata besojnë se është ndërtuar në një zonë ku nuk duhej të ishte lejuar.

Në lidhje me ndikimet e projektit në turizëm, veçanërisht mbi lundrimin me kajak, ankuesit raportuan këndvështrimin e tyre që, ndërkohë që në të kaluarën mund të kishte qenë e mundur të kishte rrjedhë të mjaftueshme për kajakët gjatë disa ditëve, rrjedha e tanishme e lumit nuk do ta lejojë më këtë gjë.

Ankuesit theksuan gjithashtu mosdakordësinë e tyre me përfundimet e hetimit të CAO në lidhje me mbikëqyrjen nga IFC të ndikimeve të projektit mbi biodiversitetin në lumin e Lengaricës.

Përfundime

IFC ka raportuar një numër vendimesh të marra dhe/ose të propozuara në nivel projekti në përgjigje të hetimit nga CAO të investimit të saj në enso Shqipëri, për sa i përket HEC Lengarica.

Hetimi i CAO gjeti mangësi në publikimin nga IFC të vlerësimit të ndikimeve M&S të projektit, dhe në publikimin nga klienti të informacionit të monitorimit M&S. Ky raport monitorimi pranon publikimin nga IFC të VNMS e projektit të vitit 2011, si dhe përditësimet e rregullta publike të rezultateve të monitorimit nga klienti të rrjedhës së lumit të Lengaricës. Duke marrë parasysh përgjigjen e IFC ndaj përfundimeve të hetimit të lidhura me publikimin e informacionit CAO do të përfundojë monitorimin e kësaj çështjeje.

Në lidhje me përafrimin e projektit me planin e menaxhimit të Parkut Kombëtar, ndikimet e mundshme mbi turizmin, dhe angazhimi përkatës i palëve të interesuara, IFC raporton një numër veprimesh të filluara me klientin. Në veçanti, IFC raporton rreth përpjekjeve të klientit për tu angazhuar me autoritetet përkatëse kombëtare rreth pjesëmarrjes së enso Shqipëri në zhvillimin e planeve të menaxhimit për parkun kombëtar ku gjendet projekti, përfshirë mundësitë për të mundësuar turizmin në zonë. Megjithatë, IFC ka raportuar gjithashtu që kërkohet progres i mëtejshëm për të arritur objektivat e planit të veprimit dhe për të trajtuar me efektivitet përfundimet e hetimit. IFC ka vënë në dukje që po planifikonte një vizitë mbikëqyrjeje për të vlerësuar mundësitë për angazhim më efektiv në këtë kontekst.

Ndërkohë që pranon përparimin e bërë nga kompania siç raportohet nga IFC, me qëllim që të mbyllet ky proces monitorimi me një rezultat të kënaqshëm, CAO do të inkurajonte IFC që t'i jepte kompanisë këshillim dhe asistencë të përshtatshme në lidhje me:

- (a) përpjekjet e saj për tu angazhuar me autoritetet kombëtare, veçanërisht në lidhje me zhvillimin e planeve të menaxhimit të Parkut Kombëtar dhe çdo rregullime të tjera përkatëse në menaxhimin e ndikimeve mjedisore dhe sociale të projektit; dhe
- (b) angazhimin e palëve të interesuara për të vlerësuar me efektivitet dhe trajtuar ndikimet e projektit mbi turizmin, duke përfshirë këshillimin me autoritetet lokale dhe operatorët turistikë.

Megjithëse CAO e kupton që kundërshtimi i vazhdueshëm i projektit nga ankuesit paraqet një vështirësi për konsultime efektive, PS1 kërkon angazhim të vazhdueshëm të palëve të interesuara. Në këtë rast kjo përsfshin përpjekje të vullnetit të mirë për tu angazhuar me kundërshtarët e projektit, duke përfshirë dhe ankuesit.

CAO do ta mbajë të hapur hetimin për të monitoruar këto veprime dhe planifikon të nxjerrë një raport monitorimi pasues jo më vonë se Nëntor 2020.